



REPUBLIKA E KOSOVËS - PRESIDENTJA  
REPUBLIC OF KOSOVO - THE PRESIDENT  
REPUBLIKA KOSOVO - PREDSEDNICA



**AUTORIZIM PËR KRYERJEN E VEPRIMEVE TË NDËRLIDHURA PËR  
LIDHJEN E MARRËVESHJES NDËRKOMBËTARE E CILA HYN NË FUQI  
NË MOMENTIN E NËNSHKRIMIT**

Nr. 04 /2024

Presidentja e Republikës së Kosovës,  
në mbështetje të nenit 84 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 6 të Ligjit Nr. 03/L-094 për Presidentin e Republikës së Kosovës (GZ, nr. 47, 25 janar 2009), dhe nenit 7 (paragrafët 3, 7, 8 dhe 9) të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare (GZ nr. 28, 16 dhjetor 2011), si dhe duke marrë parasysh kërkesën për Autorizim të Ministrit të Ministrisë së Shëndetësisë, të pranuar nga Zyra e Presidentes, me datë 29.01.2024 (Lënda Nr. Prot.:01/93-104-01/24), Vendimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës për afatin kohor të lidhjes së marrëveshjes ndërkombëtare (Vendimi nr. Ref. 29/2024, të datës 29.01.2024) si dhe konfirmimit zyrtar nga Aleanca GAVI se kjo marrëveshje nuk përmban detyrime të bashkëfinancimit për Republikën e Kosovës (13.11.2023):

**A U T O R I Z O N**

Z. Arben Vitia, Minister i Ministrisë së Shëndetësisë për kryerjen e veprimeve të ndërlidhura për lidhjen e Marrëveshjes Kornizë të Partneritetit për Mbështetje me Vaksina dhe/ose para të Gatshme, në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës, përfaqësuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Aleancës GAVI, e cila hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit.

Vjosa Osmani - Sadriu

Presidente e Republikës së Kosovës

Prishtinë, më 30 . 01 .2024

**Autorizimi t'i dërgohet:**

- Ministrit të Ministrisë së Shëndetësisë;
- Ministres së Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- a/a.

ALEANCA GAVI

DHE

QEVERIA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

---

MARRËVESHJE KORNIZË E PARTNERETIT

PËR

MBËSHTETJE ME VAKSINA DHE/OSE PARA TË GATSHME

JANAR 2024

---

**KJO MARRËVESHJE KORNIZË E PARTNERETIT** (kjo "Marrëveshje") është e datës 31 janar 2024 ("Data e hyrjes në fuqi") ndërmjet:

- (1) **ALEANCËS GAVI**, një fondacion i pavarur jofitimprurës sipas kuptimit të neneve 80 deri në 89 të Kodit Civil Zvicëran, me adresë të regjistruar në Kampusin Global të Shëndetit, Chemin du Pommier 40, 1218 Le Grand-Saconnex, Zvicër ("GAVI"); dhe
- (2) **QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS** ("Vendi"), e përfaqësuar nga Ministria e Shëndetësisë ("Qeveria"),

(secila veç e veç do të referohen si "Palë" dhe së bashku si "Palët").

## **HYRJE:**

(i) GAVI mbështet vendet për të futur në përdorim vaksina të reja dhe për ta zgjeruar shtrirjen e shërbimeve të imunizimit. Qeveria është e përkushtuar ndaj imunizimit dhe e konsideron atë si një komponent thelbësor në planin e saj kombëtar shëndetësor. GAVI kërkon ta harmonizojë mbështetjen e tij pas planeve të tilla kombëtare të imunizimit dhe shëndetësisë.

(ii) Herë pas here, Qeveria mund të ftohet t'ia paraqesë GAVIT një aplikim duke kërkuar nga ky i fundit që të sigurojë mbështetje përmes vaksinave dhe/ose parave të gatshme për aktivitetet e saj të imunizimit dhe fuqizimin e sistemeve të saj shëndetësore. Nëse Qeveria paraqet një aplikim, GAVI do ta shqyrtojë dhe mund ta tregojë synimin e tij për ta mbështetur programin e përcaktuar në këtë aplikim, duke miratuar një buxhet shumëvjeçar për të gjithë programin dhe, në varësi të disponueshmërisë së financimit dhe performancës së kënaqshme nga ana e Vendit, do ta miratojë një ose më shumë shuma për mbështetje për një program të tillë për kohëzgjatjen e tij.

(iii) Palët po hyjnë në këtë Marrëveshje për t'i përcaktuar termat dhe kushtet që do t'i rregullojnë të gjitha programet aktuale dhe ato të ardhshme, siç përshkruhet në këtë Marrëveshje.

(iv) Sa herë që GAVI miraton një shumë fillestare të mbështetjes sipas një buxheti shumëvjeçar të një programi, GAVI do t'i përcaktojë termat e programit në një letër vendimi përpara fillimit të programit. Termat e tilla të programit të përcaktuara në letërën e vendimit do të përditësohen pas çdo miratimi (dhe çdo ndryshimi të mëpasshëm) të një shume mbështetjeje sipas programit.

Palët **DAKORDOHEN** si në vijim:

### **1. Përkufizimet dhe interpretimi**

Të gjitha termat e përkufizuara të përdorura në këtë Marrëveshje (duke përfshirë Shtojcat dhe Letrat e Vendimit) janë paraqitur në Shtojcën 1, përveç rasteve kur përcaktohet ose thuhet ndryshe në këtë Marrëveshje.

### **2. Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje**

Kjo Marrëveshje përcakton termat dhe kushtet që zbatohen për të gjitha programet aktuale dhe ato të ardhshme të ndërmarra nga Qeveria dhe të financuara nga GAVI, drejtpërdrejt ose tërthorazi nëpërmjet partnerëve të GAVI-t (duke përfshirë, pa kufizim, OBSH-në, UNICEF-in dhe PAHO-n), gjatë afatit të kësaj Marrëveshjeje.

### **3. Buxheti i Programit**

GAVI herë pas here mund të miratojë një Buxhet Programi për Kohëzgjatjen e tij të Programit. Një miratim i tillë i një Buxheti të Programit është vetëm një tregues i synimit të GAVI-t për të vënë në dispozicion një shumë të tillë për ta mbështetur Programin gjatë Kohëzgjatjes së Programit dhe gjithashtu i nënshtrohet disponueshmërisë së financimit. Miratimi i tillë i Buxhetit të Programit nuk përbën detyrim, përgjegjësi apo zotim të GAVI-t për ta vënë në dispozicion të Vendit ndonjë shumë.

### **4. Shumat vjetore**

#### **4.1. Shumat vjetore**

Në varësi të disponueshmërisë së financimit dhe performancës së kënaqshme nga ana e Vendit, GAVI mund të miratojë një ose më shumë Shuma Vjetore në kuadër të Buxhetit të Programit gjatë Kohëzgjatjes së Programit për të financuar një Program. Pas miratimit të një Shume fillestare Vjetore në kuadër të një Programi, GAVI do të përgatisë dhe do t'i dërgojë një Letër Vendimi përfaqësuesit(përfaqësuesve) të Vendit ku përcaktohen Temat e Programit të këtij Programi specifik. Pas çdo miratimi të një Shume Vjetore të mëpasshme në kuadër të këtij Programi, GAVI do të lëshojë një Letër Vendimi të mëtejshme që pasqyron Termat e Programit dhe do t'ia dërgojë Vendit atë Letër Vendimi.

#### **4.2. Përshtatjet e Shumave Vjetore**

GAVI do t'i bëjë përpjekjet e tij të arsyeshme për të vënë në dispozicion mbështetjen për Qeverinë sipas shumave dhe kohës që i njoftohen Qeverisë në një Letër Vendimi. Megjithatë, GAVI rezervon të drejtën ta përshtat shumën dhe kohën e çdo Disbursimi të mbështetjes dhe/ose të Disbursojë ndonjë shumë që është e ndryshme nga shuma e deklaruar në Letrën e Vendimit pas dorëzimit të Letrës së Vendimit në Qeveri. Kjo mund të ndodhë për arsye të ndryshme, duke përfshirë, pa kufizim, ndryshimet në nevojat e Vendit, statusin e parakualifikimit të vaksinave dhe çmimet e vaksinave në tregun global, disponueshmërinë e furnizimit me vakcina, supozimet themelore të bëra nga GAVI gjatë përcaktimit të Shumës Vjetore, disponueshmërinë e financimit dhe mbifurnizimin ose nënfurnizimin e Vendit me vakcina. Pas një përshtatjeje të tillë, GAVI do ta njoftojë Qeverinë për këto ndryshime sa më shpejt të jetë e mundur.

#### **4.3. Njoftimi i Letrës së Vendimit**

GAVI do t'ia dërgojë Qeverisë çdo Letër Vendimi të një Programi pas miratimit të shumës(shumave) vjetore nga ana e GAVI-t. Përveç nëse Qeveria njofton GAVI-n për ndonjë mosmarrëveshje me Letrën e Vendimit brenda tridhjetë (30) ditëve

kalendarike nga pranimi i kësaj Letre nga ana e Qeverisë, kjo e fundit do të konsiderohet se i ka pranuar Termat e Programit që nga data e njoftimit, siç përcaktohet në Letrën e Vendimit.

#### **5. Kushtet e disbursimit**

Miratimi dhe Disbursimi i çdo vaksine dhe furnizimit dhe/ose fondeve përkatëse nga GAVI, në përputhje me këtë Marrëveshje, do t'i nënshtrohet Kushteve të Disbursimit të përcaktuara në Shtojcën 2 që përmbushen në lidhje me këtë miratim dhe Disbursim.

#### **6. Detyrimet e bashkëfinancimit**

Kur është e nevojshme, Qeveria do t'i përmbushë të gjitha detyrimet e bashkëfinancimit të zbatueshme për sigurimin e financimit nga GAVI në përputhje me këtë Marrëveshje, qoftë duke kryer Pagesat e Bashkëfinancimit (nëse vetëprokurimi nuk zbatohet) ose duke blerë numrin e kërkuar të dozave të vaksinave, siç përcaktohet në Letrën(Letrat) e Vendimit përkatës/e.

#### **7. Dokumentacioni i programit**

##### **7.1. Shtojcat**

Të gjitha Shtojcat bashkangjitur kësaj Marrëveshjeje (të modifikuara herë pas here sipas Klauzolës 17.6 të kësaj Marrëveshjeje) do të jenë pjesë e kësaj Marrëveshjeje, duke përfshirë sa vijon:

- (a) Shtojca 1: Përkufizimet dhe interpretimi
- (b) Shtojca 2: Dispozitat shtesë në lidhje me Programet
- (c) Shtojca 3: Politika e Transparencës dhe Llogaridhënies
- (d) Shtojca 4: Politika e Bashkëfinancimit
- (e) Shtojca 5: Politika e Fuqizimit të Sistemeve Shëndetësore dhe Imunizimit

##### **7.2. Letër Vendimi**

Të gjitha dispozitat e kësaj Marrëveshjeje do të rregullojnë dhe zbatohen për të gjithë Programin(Programet) dhe Letrën(Letrat) e Vendimit ndërmjet Palëve, përveç rasteve kur modifikohet ose deklarohet ndryshe në Letrën(Letrat) e Vendimit përkatës/e. Çdo Letër Vendimi do të jetë pjesë përbërëse e dispozitave të kësaj Marrëveshjeje dhe do t'i ndryshojë ato. Çdo ndryshim në një Program të miratuar nga GAVI do t'i njoftohet Vendit dhe këto ndryshime do të pasqyrohen në Letrën vijuese të Vendimit.

##### **7.3. Politikat dhe dokumentet e GAVI-t**

Qeveria do të jetë në përputhje me të gjitha politikat, udhëzimet dhe proceset e GAVI-t që janë relevante për Programet që do të jenë pjesë e kësaj Marrëveshjeje. GAVI mund të lëshojë politika, udhëzime ose procese shtesë lidhur me Programin që do të zbatohen për këtë Marrëveshje pas Datës së hyrjes në fuqi, në përputhje me Klauzolën 17.6 të kësaj Marrëveshjeje. Të gjitha politikat, udhëzimet dhe proceset

e lidhura me Programin do të jenë të disponueshme në faqen zyrtare të GAVI-t dhe/ose do t'i dërgohen Qeverisë.

#### **7.4. Mospërputhja midis dokumenteve**

Në rast të ndonjë mospërputhjeje ndërmjet kësaj Marrëveshjeje dhe ndonjëris prej Shtojcave, do të vlejné termat e Shtojcës. Në rast të ndonjë mospërputhjeje ndërmjet kësaj Marrëveshjeje ose ndonjë Shtojce dhe një Letër Vendimi, do të vlejné termat e Letrës së Vendimit.

### **8. Përfaqësimet**

#### **8.1 Përfaqësimet e Qeverisë**

Qeveria i paraqet GAVI-t se:

- (a) Kapaciteti juridik dhe kompetencat e nevojshme: Personat që hyjnë në këtë Marrëveshje dhe çdo dokument të lidhur me të kanë kompetenca të plota, autoritet dhe kapacitet ligjor për ta ekzekutuar dhe realizuar këtë Marrëveshje dhe çdo dokument të lidhur me të, si dhe për t'i kryer aktivitetet e parashikuara sipas Programeve në emër të Qeverisë.
- (b) Pajtueshmëria me ligjet: Kjo Marrëveshje përbën një obligim ligjor, të vlefshëm dhe detyrues të Qeverisë, i zbatueshëm ndaj saj në përputhje me termat e saj. Aktivitetet në kuadër të Programeve operohen në përputhje me ligjet në fuqi.
- (c) Asnjë pretendim apo hetim: Nuk ka pretendime, hetime ose procedime në vazhdim, në pritje ose (në dijeninë e saj) që i kanosen Qeverisë, zyrtarëve ose individëve të ngarkuar ose që punojnë për Programet, të cilat, nëse përcaktohen negativisht, do të kishin ndikim negativ material në zbatimin të Programeve.
- (d) Saktësia e informatave: Të gjitha informatat që i jepen GAVI-t, duke përfshirë aplikimet e tij, raportet e progresit, çdo dokumentacion mbështetës dhe informata ose raporte të tjera operative dhe financiare, janë të sakta dhe korrekte që nga data e dhënies së këtyre informatave.
- (e) Mungesa e ngjarjeve të caktuara: Asnjë shkelje reale apo e dyshuar e detyrimeve nga ana e Qeverisë sipas kësaj Marrëveshjeje nuk ka ndodhur dhe nuk është në vazhdim.

#### **8.2 Përfaqësimet e përsëritura**

Përfaqësimet nga Qeveria të përcaktuara në Klauzolën 8.1 do të konsiderohen të përsëritura në datën e çdo Disbursimi të furnizimeve dhe fondeve sipas kësaj Marrëveshjeje, duke iu referuar fakteve dhe rrethanave ekzistuese asokohe.

### **9. Asnjë Përgjegjësi**

Vendi do të jetë i vetmi përgjegjës për çdo përgjegjësi që mund të lindë në lidhje me: (i) zbatimin e secilit Program në Vend; dhe (ii) përdorimin ose shpërndarjen e vaksinave dhe furnizimeve përkatëse pasi titulli i këtyre furnizimeve i ka kaluar Vëndit. Asnjëra palë nuk do të jetë përgjegjëse për ndonjë defekt në vaksina dhe furnizime përkatëse, të cilat mbeten përgjegjësi e prodhuesit përkatës. GAVI nuk do të jetë përgjegjës për sigurimin e fondeve shtesë për ta zëvendësuar ndonjë vaksinë

dhe furnizim të lidhur që është me defekt, ose është bërë me defekt, ose që diskualifikohet për çfarëdo arsye.

#### **10. Sigurimi**

Përveç rasteve kur dakordohet ndryshe me GAVI-n, Qeveria do të mbajë, kur është e mundur me një kosto të arsyeshme, sigurimin e pasurisë për të gjitha rreziqet mbi asetet e Programit (përfshirë vaksinat dhe furnizimet e lidhura me vaksinat) dhe sigurimin gjithëpërfshirës të përgjegjësisë së përgjithshme me kompani sigurimesh të shëndosha dhe me reputacion financiar. Mbulueshmëria e sigurimit duhet të jetë në përputhje me atë të mbajtur nga subjekte të ngjashme të angazhuara në aktivitete të krahasueshme.

#### **11. Dëmshpërblimi**

Në varësi të Klauzolës 9 të kësaj Marrëveshjeje, Vendi do ta mbrojë dhe dëmshpërblejë GAVI-n dhe zyrtarët, drejtorët, punonjësit dhe agjentët e tanishëm dhe të mëparshëm, dhe do ta mbajë atë dhe ata të dëmtuar nga dhe kundrejt çdo humbje, kosto, pretendimi, shpenzimi, detyrimi, kërkesë, dëmi dhe tarife të shkaktuara nga ai dhe ata (përfshirë tarifat e arsyeshme të këshilltarit) që rrjedhin nga çdo pretendim, veprim ose mosmarrëveshje e sjellë në lidhje me Programet ose furnizimin e vaksinave dhe furnizimet e lidhura me sigurimin e financimit sipas kësaj Marrëveshjeje.

#### **12. Kohëzgjatja**

Kjo Marrëveshje do të mbetet në fuqi derisa të gjitha Programet në kuadër të saj të kenë skaduar dhe derisa Vendi të mos marrë më mbështetjen e GAVI-t, ose edhe më herët, nëse GAVI e ndërpret këtë Marrëveshje me njoftim me shkrim drejtuar Qeverisë, ku kjo ndërprerje do të jetë efektive që nga data e përcaktuar në njoftimin nga GAVI.

#### **13. Antikorrupsioni**

Qeveria do të sigurohet që çdo praktikë që është ose mund të interpretohet si praktikë e paligjshme ose korruptive në Vend të mos ndodhë në lidhje me asnjë Program. Qeveria nuk duhet, dhe do të sigurojë që punonjësit e saj, përfaqësuesit, agjentët, përfituesit ose çdo person tjetër që punon për të ose në emër të saj nuk do të ofrojnë, japin, marrin ose kërkojnë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, shpërblime, favore, dhurata ose ndonjë gjë tjetër me vlerë ose përfitim: (i) në lidhje me ndonjë proces prokurimi që lidhet me ndonjë Program; (ii) të ndikojë në veprimin e ndonjë personi në lidhje me miratimin ose aprovimin e financimit sipas kësaj Marrëveshjeje; (iii) të ndikojë në mënyrë jo të duhur në aktivitetet në lidhje me zbatimin e ndonjërit Program; ose (iv) të ndikojë në përzgjedhjen e vaksinave nga një prodhues i veçantë vaksine. Qeveria do t'u kërkojë çdo subjekti me të cilin ajo lidh ndonjë marrëveshje për nëngrante që t'u vendosë detyrime të ngjashme pranuesve të nëngranteve.

#### **14. Antiterrorizmi dhe pastrimi i parave**

Qeveria do të sigurojë që të mos përdoren fonde: (i) për të mbështetur ose nxitur dhunën, luftën ose shtypjen e popullatës së përgjithshme të ndonjë vendi, për të ndihmuar terroristët ose aktivitetet terroriste, për të kryer aktivitete të pastrimit të parave ose për të financuar organizata ose individë të lidhur me terrorizmin ose që janë të përfshirë në aktivitete të pastrimit të parave; ose (ii) për të paguar persona ose subjekte, ose për të importuar mallra, nëse pagesa ose importi i tillë, në dijeni ose besim të Qeverisë, është i ndaluar me vendim të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të marrë sipas Kapitullit VII të Kartës së Kombeve të Bashkuara, duke përfshirë sipas Rezolutës 1373 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe rezolutave përkatëse. Qeveria do t'u kërkojë çdo subjekti me të cilin ajo lidh ndonjë marrëveshje për nëngrante që t'u vendosë detyrime të ngjashme pranuesve të këtyre nëngranteve. Nëse gjatë rrjedhës së kësaj Marrëveshjeje, Qeveria zbulon çfarëdo lidhjeje ndërmjet Programeve dhe/ose fondeve të ofruara nga GAVI sipas kësaj Marrëveshjeje me ndonjë organizatë ose individ që ka lidhje me terrorizëm, ajo do ta informojë menjëherë GAVI-n me shkrim.

#### **15. Taksat**

Fondet e GAVI-t të parashikuara sipas kësaj Marrëveshjeje nuk do të përdoren për të paguar asnjë tatim, doganë, tarifë, pagesë ose ngarkesa të tjera të vendosura në importimin e vaksinave dhe furnizimeve të lidhura me to. Qeveria do të përdorë përpjekjet e saj të arsyeshme për t'i ngritur mekanizmat e duhur për të përjashtuar nga tarifat dhe taksat të gjitha blerjet e bëra në nivel lokal dhe ndërkombëtar me fondet e GAVI-t.

#### **16. Të Drejtat e Pronësisë Intelektuale të GAVI-t**

GAVI do të mbetet pronar ekskluziv i të gjitha të drejtave të pronësisë intelektuale të GAVI-t, në masën që ato janë të rëndësishme për marrëveshjet e parashikuara nga kjo Marrëveshje që ekzistojnë në Datën e hyrjes në fuqi. GAVI i licencon Qeverisë pa pagesë dhe në baza joekskluzive në mbarë botën, të drejtat e pronësisë intelektuale që i përkasin GAVI-t, të cilat janë të nevojshme për t'i mundësuar Qeverisë të zbatojë ose operojë Programet, ose të përdorë emrin ose çdo përfaqësim të stilizuar të GAVI-t. Pas përfundimit të kësaj Marrëveshjeje, kjo licencë do të përfundojë automatikisht pa ndonjë veprim të mëtejshëm nga ana e GAVI-t dhe Qeveria do të ndërpresë menjëherë përdorimin e këtyre të Drejtave të Pronësisë Intelektuale.

#### **17. Dispozitat e përgjithshme**

##### **17.1. Interpretimi i dispozitave në këtë Marrëveshje**

Kushtet e kësaj Marrëveshjeje do të interpretohen dhe zbatohen në përputhje me kuptimin e tyre të vërtetë dhe efektin e synuar, pavarësisht nga çdo sistem i ligjit kombëtar, qoftë ai federal apo ai shtetëror.

##### **17.2. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**



Çdo mosmarrëveshje, polemikë ose pretendim ("**Mosmarrëveshje**") midis Palëve që lind nga ose në lidhje me këtë Marrëveshje ose ndonjë Letër Vendimi që nuk zgjidhet miqësisht brenda një periudhe prej katër (4) javësh nga data kur Mosmarrëveshja i është njoftuar për herë të parë Palës tjetër, do t'i nënshtrohet arbitrazhit me kërkesë të cilësdo palë. Arbitrazhi do të kryhet në përputhje me rregullat e atëhershme aktuale të Komisionit të Kombeve të Bashkuara për të Drejtën Ndërkombëtare të Tregtisë ("**Rregullat e Arbitrazhit UNCITRAL**"). Për çdo Mosmarrëveshje për të cilën shuma në fjalë është 100,000 dollarë amerikanë ose më pak, do të ketë një arbitër të caktuar nga GAVI. Për çdo Mosmarrëveshje për të cilën shuma në fjalë është më e madhe se 100,000 dollarë amerikanë, GAVI dhe Qeveria do të caktojnë secila nga një arbitër, dhe dy arbitrat e emëruar në këtë mënyrë do të caktojnë së bashku një arbitër të tretë i cili do të jetë kryesuesi. Nëse ndonjëra Palë dështon të caktojë një arbitër, autoriteti emëruar në vend të kësaj do të jetë Presidenti i Shoqatës Zvicerane të Arbitrazhit. Procedurat e arbitrazhit do të zhvillohen në Gjenevë dhe do të zhvillohen në gjuhën angleze. Palët bien dakord të jenë të detyruara nga çdo vendim arbitrazhi, si gjykimi përfundimtar i çdo Mosmarrëveshjeje.

### **17.3. Mos-heqja dorë nga privilegjet dhe imunitetet**

Asgjë e përfshirë në këtë Marrëveshje ose në lidhje me të nuk do të konsiderohet heqje dorë, e shprehur ose e nënkuptuar, nga ndonjë prej privilegjeve dhe imuniteteve të GAVI-t dhe asnjë dispozitë e kësaj Marrëveshjeje nuk do të interpretohet ose zbatohet në ndonjë mënyrë, ose në atë masë, që është në kundërshtim me ato privilegje dhe imunitete.

### **17.4. 'Mbijetesa'**

Klauzolat 5, 6, 9, 11, 13, 14, 16 dhe 17 do t'i 'mbijetojnë' skadimit ose përfundimit të kësaj Marrëveshjeje.

### **17.5. Marrëveshja e plotë**

Kjo Marrëveshje (dhe të gjitha Shtojcat) dhe Letra(t) e Vendimit përfaqësojnë të gjithë marrëveshjen ndërmjet Palëve në lidhje me objektin e kësaj Marrëveshjeje dhe zëvendësojnë të gjitha komunikimet, mirëkuptimet dhe marrëveshjet e mëparshme ndërmjet Palëve në lidhje me këtë temë, qofshin ato gojore ose të shkruara. Të gjitha dispozitat e kësaj Marrëveshjeje (përfshirë Shtojcat) dhe Letrat e Vendimit do të mbeten të zbatueshme ndërmjet Palëve edhe kur Vendi merr financim të GAVI-t nëpërmjet një prej partnerëve të GAVI-t (duke përfshirë, pa kufizim, OBSH-në, UNICEF-in dhe PAHO-n) në përputhje me marrëveshjen ndërmjet GAVI-t dhe një partneri të tillë.

### **17.6. Modifikimi i kësaj Marrëveshjeje**

Asnjë modifikim i kësaj Marrëveshjeje (përveç Shtojcave dhe Letrave të Vendimit bashkangjitur kësaj Marrëveshjeje) nuk do të jetë i vlefshëm përveç nëse është me shkrim dhe nënshkruar nga Palët. GAVI mund të shtojë ose fshijë Shtojca ose t'i

termat në Shtojcat e kësaj Marrëveshjeje dhe këto shtesa, fshirje dhe modifikime do të zbatohen për Qeverinë që nga data e njoftimit për këto ndryshime. Nëse Qeveria nuk pajtohet me ndonjë nga ndryshimet e propozuara nga GAVI në Shtojca, ajo do ta njoftojë GAVI-n për çdo mosmarrëveshje brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike nga njoftimi për këto ndryshime. Pavarësisht Klauzolës 17.2, nëse Palët nuk arrijnë ta zgjidhin ndonjë mosmarrëveshje sipas kësaj Klauzole brenda një periudhe të arsyeshme kohore, secila Palë do të ketë të drejtën ta ndërpresë këtë Marrëveshje.

#### **17.7. Pasardhësit dhe detyrat**

Kjo Marrëveshje do të jetë e detyrueshme për pasardhësit dhe të caktuarit e secilës Palë dhe Marrëveshja do të konsiderohet se përfshin pasardhësit dhe të caktuarit e Palës. Megjithatë, asnjë caktim ose transferim nga Qeveria i të drejtave ose detyrimeve të saj sipas kësaj Marrëveshjeje nuk do të jetë efektiv pa miratimin paraprak me shkrim të GAVI-t.

#### **17.8. Autoritetet nënshkruese**

Kur kërkohet nga GAVI, Qeveria do të sigurojë dëshmi të kënaqshme për autoritetin e personave të autorizuar për ta nënshkruar këtë Marrëveshje.

#### **17.9. Homologët**

Kjo Marrëveshje mund të ekzekutohet në një ose më shumë homologë, të cilët do të kenë të njëjtin efekt sikur nënshkrimet në homologë të ishin në një kopje të vetme të kësaj Marrëveshjeje.

#### **17.10. Përfshirja e të drejtave të palëve të treta**

Përveç rasteve kur shprehimisht thuhet e kundërta, asnjë pjesë e kësaj Marrëveshjeje nuk do të krijojë asnjë të drejtë në favor të ndonjë pale të tretë që nuk është Palë e kësaj Marrëveshjeje, e cila do të imponojë ndonjë detyrim ose do të jetë e zbatueshme ndaj GAVI.

**Në dëshmi të kësaj**, përfaqësuesit e autorizuar siç duhet të Palëve kanë hyrë në këtë Marrëveshje që nga Data e hyrjes në fuqi.

**Në emër të Aleancës GAVI**

**ALEANCA  
GAVI**

Nga  
(Nënshkrimi):

Emri (me shkronja të  
mëdha):

**Në emër të REPUBLIKËS SË  
KOSOVËS**

**MINISTRI I SHËNDETËSISË**

Nga (Nënshkrimi):

Emri (me shkronja të mëdha): **Dr  
ARBEN VITIA**  
Titulli: **Ministër i Shëndetësisë**

Data: 31/01/2024

Titulli:

Data: 31/01/2024

## SHTOJCA 1

### Përkufizimet dhe interpretimi

#### 1. Përkufizimet

Termet e mëposhtëm (dhe çdo ndryshim i tyre) do të kenë kuptimet e përcaktuara më poshtë në këtë Marrëveshje:

<b>Shuma Vjetore</b>	nënkupton, në lidhje me secilin Program, një shumë vjetore të vlerësuar, të miratuar nga GAVI sipas këtij Programi;
<b>Raporti Vjetor i Progresit</b>	nënkupton, në lidhje me secilin Program, një raport vjetor të Vendit që tregon progresin drejt arritjes së objektivave të Programit në vitin e kaluar, të paraqitur nga Qeveria për GAVI-n;
<b>Pagesa e Bashkëfinancimit</b>	nënkupton, në lidhje me secilin Program, një shumë të pagueshme në përputhje me Politikën e Bashkëfinancimit nga Qeveria për kostot e vaksinave dhe furnizimeve të lidhura, sipas detyrimeve të saj të bashkëfinancimit, duke përfshirë tarifën e trajtimit, tarifën e transportit dhe tarifën buferike;
<b>Politika e Bashkëfinancimit</b>	nënkupton politikën e bashkëfinancimit të GAVI-t bashkangjitur si Shtojca 3 (e ndryshuar herë pas here);
<b>Letra e Vendimit</b>	nënkupton, në lidhje me secilin Program, një letër që përmban Termat më të fundit të Programit, në një formë të dhënë nga GAVI;
<b>Disbursimi</b>	nënkupton: (i) pagesën e parave të gatshme për një Agjenci Prokurimi nga GAVI për prokurimin e vaksinave dhe furnizimeve të lidhura me to nga kjo Agjenci e Prokurimit në dobi të Vendit (ii) pagesën e parave të gatshme për Qeverinë për prokurimin e vaksinave dhe furnizimeve që lidhen me to përmes agjencisë së vet të prokurimit; ose (iii) pagesën e parave të gatshme për Qeverinë për të kryer aktivitetet sipas Programeve të saj të bazuara në para të gatshme dhe shprehjet " <b>Disburso</b> " dhe " <b>Disbursuar</b> " do të interpretohen në përputhje me rrethanat;
<b>Kushti i Disbursimit</b>	nënkupton, në lidhje me çdo Disbursim sipas një Programi, një kusht që duhet të plotësohet nga Vendi përpara një Disbursimi të tillë të përcaktuar në Shtojcën 2 dhe kudo tjetër në këtë Marrëveshje;

<b>Subjektet</b>	do ta kenë kuptimin që u jepet në paragrafin 6 të Shtojcës 2 të kësaj Marrëveshjeje;
<b>Kërkesat e Menaxhimit Financiar</b>	nënkupton kërkesat dhe masat për zbutjen e rrezikut financiar të rënë dakord ndërmjet Palëve në përputhje me Politikën e TAP-it bashkangjitur si Shtojcë e kësaj Marrëveshjeje;
<b>Politika për Fuqizimin e Sistemit Shëndetësor dhe Imunizimit</b>	nënkupton Politikën e GAVI-t për Fuqizimin e Sistemit Shëndetësor dhe Imunizimit bashkëngjitur si Shtojcë 5 (e ndryshuar herë pas here);
<b>Të Drejtat e Pronësisë Intelektuale</b>	nënkupton markat tregtare, markat e shërbimit, emrat e domeneve, logot, emrat tregtarë ose të biznesit, të drejtat e autorit, të drejtat në të dhënat dhe bazat e të dhënave, njohuritë dhe informacionin konfidencial në çdo pjesë të botës;
<b>Keqpërdorimi</b>	do ta ketë kuptimin që i jepet në paragrafin 20 të Shtojcës 2 të kësaj Marrëveshjeje;
<b>PAHO</b>	nënkupton Organizatën Shëndetësore Panamerikane;
<b>Agjencia e Prokurimit</b>	do ta ketë kuptimin që i jepet në paragrafin 9 të Shtojcës 2 të kësaj Marrëveshjeje;
<b>Programi</b>	nënkupton një program të tërë që lidhet me (i) sigurimin e një lloji vaksine dhe furnizimeve të lidhura me të; ose (ii) mbështetjen në para, e cila miratohet nga GAVI;
<b>Aktivitetet e Programit</b>	nënkupton, në lidhje me secilin Program, aktivitetet e përshkruara në aplikimin e Vendit dhe çdo ndryshim të mëvonshëm (duke përfshirë në Raportet Vjetore përkatëse të Progresit) të Programit (nëse ka) të miratuar nga GAVI;
<b>Buxheti i Programit</b>	nënkupton, në lidhje me secilin Program, një shumë totale të një buxheti të vlerësuar shumëvjeçar, të miratuar nga GAVI sipas këtij Programi;
<b>Dokumentet e Programit</b>	do ta kenë kuptimin që u jepet në paragrafin 22.2 të Shtojcës 2 të kësaj Marrëveshjeje;
<b>Kohëzgjatja e Programit</b>	nënkupton të gjithë kohëzgjatjen e një Programi;
<b>Termet e Programit</b>	nënkupton, në lidhje me secilin Program, termat dhe kushtet e këtij Programi siç përcaktohen në këtë Marrëveshje dhe në Letrën përkatëse të Vendimit;

<b>Pranuesit e Nëngrantit</b>	do ta kenë kuptimin që u jepet në paragrafin 5 të Shtojcës 2 të kësaj Marrëveshjeje;
<b>Politika e TAP</b>	nënkupton Politikën e GAVI-t për Transparencë dhe Llogaridhënie, bashkangjitur si Shtojca 4 (e ndryshuar herë pas here);
<b>UNICEF</b>	nënkupton Fondin e Kombeve të Bashkuara për Fëmijët;
<b>Granti për futjen në përdorim të vaksinës</b>	nënkupton një shumë të dhënë nga GAVI për të mbështetur aktivitetet e përfshira në futjen në përdorim të një vaksine të re në Vend; dhe
<b>OBSH</b>	nënkupton Organizatën Botërore të Shëndetësisë.

## 2. Interpretimi

Për qëllimin e kësaj Marrëveshjeje, "kjo Marrëveshje", ku e kërkon konteksti, do t'i përfshijë të gjitha Shtojcat dhe Letrat e Vendimit.

## SHTOJCA 2

### Dispozitat shtesë në lidhje me Programet

#### Seksioni A: Termat e përgjithshëm

##### 1. Kushtet e disbursimit

Në lidhje me çdo miratim dhe Disbursim sipas një programi, do të zbatohen Kushtet e mëposhtme të Disbursimit:

- (a) Financim i mjaftueshëm: GAVI ka përcaktuar se ka fonde të mjaftueshme për ta kryer Disbursimin në kohën përkatëse;
- (b) Performancë e kënaqshme: GAVI është i kënaqur që Vendi ka kryer detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje dhe Letrave të Vendimit;
- (c) Udhëzimet dhe politikat: Qeveria ka respektuar kërkesat e përcaktuara në udhëzimet dhe politikat e GAVI-t të disponueshme në format e aplikacioneve, raporteve të progresit, shabllone të tjera dhe në faqen zyrtare të GAVI-t, në një mënyrë të kënaqshme për GAVI-n;
- (d) Sqarime dhe shtjellime: Qeveria ka paraqitur çdo sqarim të kërkuar nga GAVI në Letrën(Letrat) e Vendimit përkatëse të Programit në lidhje me aplikimin e tij dhe Raportet Vjetore të Progresit, në kohën e duhur dhe në mënyrë të kënaqshme për GAVI-n;
- (e) Bashkëfinancim: kur Qeverisë i kërkohet të kryejë Pagesat e Bashkëfinancimit, Qeveria ka përmbushur detyrimet e saj të bashkëfinancimit për vitet e mëparshme kalendarike sipas Programit në përputhje me këtë Marrëveshje, Politikën e Bashkëfinancimit dhe Letrën(Letrat) e Vendimit përkatëse;
- (f) Dokumentet: Qeveria i ka dorëzuar GAVI-t të gjitha dokumentet ose informacionet, duke përfshirë raportet e auditimit, regjistrimet ose llogaritë e kërkuara sipas kësaj Marrëveshjeje (përfshirë Shtojcat) dhe ndryshe siç kërkohet nga GAVI herë pas here në Letrat e Vendimit përkatëse ose përmes komunikimit tjetër, në kohën e duhur dhe në mënyrë të kënaqshme për GAVI-n;
- (g) Asnjë shkelje: GAVI është i bindur se pezullimi ose ndërprerja, përfshirë si rezultat i Keqpërdorimit, të ndonjë Programi nuk do të ketë ndikim negativ në zbatimin e Programit përkatës;
- (h) Politika e TAP: (për paratë e gatshme të Disbursuara nga GAVI për çdo program) Qeveria ka respektuar kërkesat e atëhershme aktuale sipas Politikës së TAP-it dhe Kërkesave të Menaxhimit Financiar (nëse është rënë dakord) siç përcaktohet në një Shtojcë të kësaj Marrëveshjeje;
- (i) Pasqyrat financiare dhe auditimet e jashtme: (për paratë e gatshme të Disbursuara nga GAVI për çdo Program) Qeveria ka respektuar kërkesat e atëhershme aktuale të GAVI-t në lidhje me monitorimin dhe vlerësimin, ofrimin e pasqyrave financiare dhe kryerjen e auditimeve të jashtme; dhe
- (j) Kushtet e tjera: Qeveria ka përmbushur të gjitha kushtet e tjera të përcaktuara në Letrën(Letrat) e Vendimit përkatëse dhe pjesë të tjera të kësaj Marrëveshjeje.

## **2. Letrat e Vendimit**

### **2.1. Forma e Letrës së Vendimit**

Çdo Letër Vendimi do t'i përcaktojë Termat e Programit të një Programi të vetëm, forma e së cilës do të jepet nga GAVI herë pas here.

### **2.2. Ndryshimet në Letrat e Vendimeve dhe Programet**

GAVI mund të ndryshojë shumën dhe kohëzgjatjen e mbështetjes që do të ofrohet sipas një Programi, duke përfshirë Buxhetin e Programit, Shumën Vjetore, Pagesën e Bashkëfinancimit dhe Kohëzgjatjen e Programit, dhe Aktivitetet e Programit të një Programi specifik dhe do t'i pasqyrojë këto ndryshime në një Letër Vendimi vijuese. Qeveria gjithashtu mund të kërkojë çdo ndryshim të rëndësishëm në Termat e Programit duke njoftuar GAVI-n në Raportin Vjetor të Progresit për këto ndryshime të propozuara, të cilat do të shqyrtohen nga GAVI në përputhje me udhëzimet e saj.

## **3. Zbatimi i Marrëveshjes për të gjitha Programet**

### **3.1. Programet ekzistuese dhe ato të ardhshme**

Termat dhe kushtet e kësaj Marrëveshjeje (duke përfshirë Shtojcat) dhe Letrat përkatëse të Vendimit do të zbatohen për të gjitha disbursimet e ardhshme që do të bëhen pas Datës së hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje sipas programeve ekzistuese dhe atyre të ardhshme që do të ndërmerren nga Qeveria në Datën e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje si dhe më pas gjatë afatit të kësaj Marrëveshjeje.

### **3.2. Programet paraekzistuese**

Ne lidhje me disbursimet që janë bërë përpara Datës së hyrjes në fuqi sipas Programeve që janë në zhvillim e sipër në Datën e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, kjo Marrëveshje do të zbatohet për:

(a) të gjitha aktivitetet që do të ndërmerren nga Qeveria pas Datës së hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje; dhe

(b) të gjitha shumat e financimit dhe furnizimeve që janë Disbursuar, por nuk janë përdorur ose zotuar për t'u përdorur në Datën e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

Për t'i shmangur dyshimet, të gjitha aplikimet e ardhshme të financimit dhe vaksinave sipas këtyre Programeve ekzistuese do të përdoren, dhe të gjitha financimet e ardhshme që do të sigurohen do të disbursohen, vetëm në përputhje me termat dhe kushtet e kësaj Marrëveshjeje.

Çdo term dhe kusht i zbatueshëm për çdo disbursim të kaluar sipas Programeve ekzistuese që nuk janë në përputhje me termat në këtë Marrëveshje siç janë përcaktuar më sipër, ndryshohen me marrëveshje të ndërsjellë midis Palëve që nga Data e hyrjes në fuqi.

### **3.3. Aranzhimet e Tranzicionit për Monitorimin dhe Raportimin**

Pavarësisht nga sa u tha më sipër, çdo detyrim shtesë i monitorimit dhe raportimit të përfshirë në këtë Marrëveshje (duke përfshirë Shtojcat dhe Letrën(Letrat) e



Vendimit përkatëse) do të zbatohet me efekt vetëm nga fillimi i periudhës së ardhshme të raportimit pas Datës së hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

#### **4. Organizatat e Shoqërisë Civile**

Përveç Qeverisë, GAVI mund të japë grante për subjekte të tjera qoftë nëpërmjet Qeverisë ose drejtpërdrejt subjekteve për aktivitete të tilla si forcimi i koordinimit dhe përfaqësimit të shoqërisë civile dhe zbatimi i programeve për forcimin e sistemeve shëndetësore në Vend. Qeveria do të bashkëpunojë sipas rastit me këto subjekte të tjera për t'i realizuar herë pas here përfitimet e të gjitha programeve të mbështetura nga GAVI në Vend, duke përfshirë organizatat e shoqërisë civile.

#### **5. Pranuesit e Nëngranteve**

Qeveria mund t'u sigurojë fonde të GAVI-t subjekteve të tjera për t'i kryer programet e mbështetura nga GAVI sipas kësaj Marrëveshjeje ("**Pranuesit e Nëngranteve**"). Nëse Qeveria ofron fonde të GAVI-t për Pranuesit e Nëngranteve, Qeveria pranon dhe bie dakord që dhënia e fondeve të GAVI-t për Pranuesit e Nëngranteve nuk e liron Qeverinë nga obligimet dhe detyrimet e saj sipas kësaj Marrëveshjeje ose nga detyrimi për t'u siguruar që fondet e GAVI-t të përdoren vetëm për qëllimet e parashikuara nga kjo Marrëveshje dhe jo ndryshe, dhe se këto fonde nuk keqpërdoren. Qeveria është përgjegjëse për veprimet dhe mosveprimet e Pranuesve të saj të Nëngranteve në lidhje me programet e mbështetura nga GAVI sikur të ishin veprime dhe mosveprime të Qeverisë. Qeveria do të sigurojë që Pranuesit e Nëngranteve të jenë në përputhje me këtë Marrëveshje (duke përfshirë Shtojcat dhe Letrën(Letrat) e Vendimit përkatëse), në veçanti, sipas Seksionit C të kësaj Shtojce dhe politikave dhe udhëzimeve të GAVI-t në lidhje me përdorimin dhe menaxhimin e fondeve të GAVI-t.

#### **6. Informatat dhe të dhënat për Vendin**

Për t'i mundësuar GAVI-t të marrë vendime të bazuara në informata në lidhje me sistemet shëndetësore të Vendit, zinxhirin e furnizimit (përfshirë zinxhirin e ftohtë) dhe aktivitetet e GAVI-t, GAVI duhet të ketë qasje në informacionin dhe të dhënat e lidhura me Vendin që mund të jenë të rëndësishme për vlerësimin e aplikimeve nga GAVI dhe monitorimin e Programeve dhe progresit. Për ta lehtësuar këtë, Qeveria pranon dhe miraton ndarjen nga ana e partnerëve të GAVI-t (përfshirë, pa kufizim, OBSH-në, UNICEF-in dhe PAHO-n), donatorëve dypalësh, Auditorit të Përgjithshëm të Vendit, auditorëve të jashtëm dhe subjekteve të tjera që kryejnë sondazhe të mbulueshmërisë dhe vlerësime të zinxhirit të ftohtë ("**Subjektet**") çdo dokument, raport, deklaram, të dhëna dhe informacion të Qeverisë (përfshirë informacionin dhe të dhënat konfidenciale), të tilla si provat në lidhje me pagesat e bashkëfinancimit dhe raportet e mbërritjes së vaksinave, si dhe analizat dhe raportet e Subjekteve të krijuara nga, ose që përmbajnë informacion dhe të dhëna, të Vendit (përfshirë Vlerësimet e Pas prezantimit dhe Vlerësimet Efektive të Menaxhimit të Vaksinave, planet e përmirësimit dhe të gjitha dokumentet përkatëse).

### **Seksioni B: Mbështetja me vakcina dhe para të gatshme**

## **7. Mbështetja me vaksina**

GAVI mund ta miratojë financimin për blerjen e vaksinave dhe furnizimeve të lidhura me to për programet e imunizimit të Vendit sipas programit të tij Vaksinat e Reja dhe të Papërdorura (NVS) dhe/ose programe të tjera që GAVI mund t'i mbështesë herë pas here.

## **8. Granti për futjen në përdorim të vaksinës**

GAVI mund t'i ofrojë Vendit Grant(e) për futjen në përdorim të vaksinave sipas një Programi në përputhje me Politikën e Fuqizimit të Sistemeve Shëndetësore dhe Imunizimit. Financimi i GAVI-t nuk synon t'i mbulojë të gjitha kostot që lidhen me futjen në përdorim të një vaksine të re në Vend. GAVI do të sigurojë financim të tillë duke kuptuar se çdo kosto që lidhet me futjen e një vaksine të re në Vend që nuk plotësohet nga GAVI do të mbulohet nga Qeveria. GAVI do ta njoftojë Qeverinë për shumën e Grantit të Futjes në Përdorim të Vaksinës në Letrën e Vendimit përkatëse të një Programi. Qeveria do të raportojë mbi përdorimin e Grantit(Granteve) për Futjen në Përdorim të Vaksinës në Raportin(raportet) Vjetore përkatëse të Progresit.

## **9. Prokurimi përmes një agjencie**

Dispozitat e mëposhtme do të zbatohen kur UNICEF-i (që vepron si Agjencia e Prokurimit për GAVI-n dhe agjent i Qeverisë për prokurim), PAHO ose ndonjë agjenci tjetër vepron si agjenci prokurimi për GAVI-n për prokurimin dhe shpërndarjen e vaksinave dhe furnizimeve të lidhura me to, sipas një Programi ("Agjencia e Prokurimit") :

- (a) GAVI do t'i Disbursojë fondet përkatëse për Agjencinë e caktuar të Prokurimit;
- (b) për blerjen e furnizimeve të bashkëfinancuara, Vendi do ta kryejë çdo pagesë të bashkëfinancimit drejtpërdrejt për Agjencinë e caktuar të Prokurimit siç është rënë dakord në çdo Memorandum Mirëkuptimi për Shërbimet e Prokurimit ndërmjet tyre;
- (c) Agjencia e Prokurimit do ta kryejë prokurimin e vaksinave dhe furnizimeve të lidhura me to, të mbështetur nga GAVI në përputhje me rregullat e Agjencisë së Prokurimit dhe çdo marrëveshje përkatëse në lidhje me një prokurim të tillë;
- (d) Vendi do t'i marrë këto furnizime drejtpërdrejt nga Agjencia e Prokurimit;
- (e) Vendi pranon që Agjencia e Prokurimit të ndajë informacione me GAVI-n mbi statusin e blerjes së pjesës së bashkëfinancuar të vaksinave dhe furnizimeve të lidhura me to;
- (f) Vendi do të mbajë kontakte me Agjencinë e Prokurimit për ta kuptuar disponueshmërinë e furnizimeve dhe eventualisht për të përgatitur orarin e dërgesave të tyre; dhe
- (g) GAVI nuk do të mbahet përgjegjës për asnjë pasojë që rrjedh nga vonesa në prokurimin ose dërgimin e vaksinave dhe furnizimeve të lidhura me to në Vend.

## **10. Vetëprokurimi**

### **10.1. Para të gatshme në vend të furnizimeve**

GAVI mund ta miratojë dhënien e parave të gatshme në vend të vaksinave dhe furnizimeve të lidhura me to për t'i lejuar Qeverisë të prokurojë furnizime të tilla nëpërmjet agjencisë së saj të prokurimit (“**Para të gatshme në vend të furnizimeve**”). Shuma Vjetore për këto Para të gatshme në vend të furnizimeve do të bazohet në vlerën ekuivalente me mesataren e ponderuar të UNICEF-it ose çmimet e vlerësuara për këto vakcina. Këto Shuma Vjetore do t'i njoftohen Qeverisë në Letrën përkatëse të Vendimit.

#### **10.2. Mekanizmi i vetëprokurimit**

Përpara Disbursimit të Shumave Vjetore për Paratë e gatshme në vend të furnizimeve, GAVI do ta kryejë një rishikim të mekanizmit të prokurimit të propozuar nga Vendi në aplikimin e tij për të vlerësuar nëse ai i përmbush standardet përgjithësisht të pranueshme të prokurimit dhe për të dhënë rekomandime për kërkesat dhe përmirësimet minimale të raportimit (nëse është e nevojshme). Qeveria do të sigurojë që vaksinat dhe furnizimet e lidhura me to të blihen sa më shpejt që të jetë e mundur, siç thuhet në këtë Marrëveshje dhe Letrën(Letrat) e Vendimit.

#### **10.3. Diferenca midis çmimeve të negociuara dhe atyre të vlerësuara**

Nëse çmimi i negociuar i Qeverisë me furnitorët është më i lartë se mesatarja e ponderuar e UNICEF-it ose çmimi i vlerësuar, Qeveria do ta paguajë diferencën për të blerë vakcina të mjaftueshme për ta arritur popullatën e synuar të ndërlidhur me Programin. Nëse çmimi i negociuar është më i ulët se mesatarja e ponderuar e UNICEF-it ose çmimi i vlerësuar, Qeveria mund t'i përdorë fondet e tepërta në programet e imunizimit dhe do ta raportojë përdorimin e këtyre fondeve tek GAVI në Raportin përkatës Vjetor të Progresit.

#### **10.4. Bashkëfinancimi**

Kur Politika e Bashkëfinancimit zbatohet për Vending dhe Qeveria prokuron vaksinat e veta, ajo duhet t'i përmbushë gjithashtu detyrimet e saj të bashkëfinancimit. Qeveria duhet t'i paraqesë GAVI-t dëshmi të kënaqshme se ka blerë pjesën e saj të bashkëfinancuar të vaksinave dhe furnizimeve të lidhura me to, duke përfshirë edhe dorëzimin e faturave ose dëftesave në GAVI.

#### **10.5. Kriteret e vetëprokurimit për vakcina**

Qeveria do të prokurojë vetëm vaksinat që: (i) janë nga lista e parakualifikuar e OBSH-së për vakcina; ose (ii) në rastin e vaksinave të prodhuara në vend të blera direkt nga prodhuesi, janë të licencuara nga Autoriteti Rregullator Kombëtar përkatës, i cili është vlerësuar si funksional nga OBSH-ja.

### **11. Kostot operative për fushatat**

Për lloje të caktuara vaksinash, GAVI mund të sigurojë fonde shtesë për t'i mbështetur kostot operacionale për fushatat në Vend që lidhen me vakcina të tilla në përputhje me Politikën e Fuqizimit të Sistemeve Shëndetësore dhe Imunizimit, e cila mbështetje do t'i disbursohet në para të gatshme Qeverisë, OBSH-së dhe/ose

UNICEF-it. Financimi i tillë do të përdoret dhe aplikohet për financimin e Aktiviteteve të Programit dhe informacioni për shumën e mbështetjes do t'i komunikohet Qeverisë në një Letër Vendimi. Financimi i GAVI-t nuk synon t'i mbulojë të gjitha kostot operacionale për fushatat. GAVI do të sigurojë financim të tillë duke kuptuar se çdo kosto operacionale për fushatat që nuk përmbushet nga GAVI do të mbulohet nga Qeveria. Qeveria do të raportojë mbi përdorimin e financimit për kostot operative në Raportin(Raportet) përkatëse Vjetore të Progresit.

## **12. Siguria e injeksioneve**

Parimet e deklaratës së përbashkët të OBSH-UNICEF-UNFPA mbi sigurinë e injeksioneve (WHO/V&B/99.25) do të zbatohen për të gjitha shërbimet e imunizimit në kuadër të Programit(Programeve).

## **13. Tarifa dhe ngarkesa të tjera**

Pagesat e Bashkëfinancimit të përcaktuara në një Letër Vendimi tregojnë kontributin e Vendi ndaj kostove vetëm për vaksinat dhe pajisjet përkatëse të sigurisë së injeksioneve. Vendi duhet të jetë i vetëdijshëm se Pagesat e Bashkëfinancimit nuk përfshijnë kostot dhe tarifat e Agjencisë përkatëse të Prokurimit, të tilla si tampon e kontingjencës dhe tarifat e trajtimit. Informatat mbi këto kosto dhe tarifa shtesë do të sigurohet nga Agjencia përkatëse e Prokurimit si pjesë e vlerësimit të kostove që do të kërkohet nga Vendi.

## **14. Mbështetja në para të gatshme**

GAVI mund të miratojë fondet për Programet që kontribuojnë në fuqizimin e kapaciteteve të sistemeve të integruara shëndetësore për të ofruar imunizimin në Vend, duke përfshirë kontributin në zgjidhjen e kufizimeve kryesore për kryerjen e imunizimit, rritjen e barazisë në qasjen e shërbimeve dhe forcimin e angazhimit të shoqërisë civile. në sektorin e shëndetësisë dhe/ose programe të tjera siç mund të mbështesë GAVI herë pas here. Nëse Qeveria merr ndonjë financim të bazuar në performancë nga GAVI, Palët do të bien dakord për treguesit e performancës, mjetet e matjes dhe procesin e monitorimit për një Program të tillë, të cilat do t'i bashkëngjiten si shtojcë Letrës përkatëse të Vendimit.

## **Seksioni C: Menaxhimi dhe përdorimi i fondeve dhe furnizimeve të GAVI-t**

### **15. Kërkesat e Menaxhimit Financiar**

Qeveria do t'i respektojë termat dhe do t'i zbatojë masat e përcaktuara në Kërkesat e Menaxhimit Financiar në afatet kohore të përcaktuara aty (nëse është e zbatueshme).

Nëse zbatohet për Vandin, Qeveria dhe GAVI do të bien dakord për disa kërkesa dhe masa për zbutjen e rrezikut financiar në lidhje me fondet e GAVI-t në përputhje me politikën e TAP-it, e cila do t'i bashkëngjitet kësaj Marrëveshjeje. Palët do të bien dakord bashkërisht për masat dhe, pas një marrëveshjeje të tillë, GAVI do t'i

dërgojë Qeverisë Kërkesat e përfunduara të Menaxhimit Financiar. Nëse Qeveria nuk e njofton GAVI-n për ndonjë mosmarrëveshje me Kërkesat e përfunduara të Menaxhimit Financiar brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike nga pranimi i tyre nga ajo (Qeveria) ose ndonjë datë tjetër të mëvonshme siç është rënë dakord ndërmjet Palëve, do të konsiderohet se Qeveria i ka pranuar termat e Kërkesave të Menaxhimit Financiar që nga data e njoftimit për to.

#### **16. Monitorimi dhe raportimi**

Përdorimi i mbështetjes me vaksina dhe para të gatshme të GAVI-t nga ana e Qeverisë i nënshtrohet monitorimit të rreptë të performancës. GAVI kërkon t'i përdorë raportet e Qeverisë dhe mekanizmat ekzistues në nivel vendi për ta monitoruar performancën. Qeveria do të monitorojë dhe raportojë mbi përdorimin e vaksinave dhe furnizimeve të lidhura me to dhe fondet e ofruara nga GAVI duke deklaruar progresin drejt arritjes së objektivave të Programit(Programeve) gjatë vitit paraardhës duke paraqitur Raportin(Raportet) Vjetor(e) të Progresit. Qeveria gjithashtu do t'i ndajë me GAVI-n raportet e saj të menaxhimit të brendshëm për përdorimin e fondeve në baza tremujore ose periodike. Qeveria gjithashtu do t'i dorëzojë të gjitha dokumentet dhe raportet që kërkohen të dorëzohen si pjesë e Raporteve Vjetore të Progresit dhe aplikimeve të Vendit. Për mbështetje të caktuar në para të gatshme, GAVI do ta monitorojë dhe rishikojë çdo vit progresin e arritur në Vend drejt objektivave të financuara të Programit(Programeve) duke marrë pjesë në rishikimin vjetor të sektorit shëndetësor përmes mekanizmave ekzistues në nivel vendi. Qeveria do të dorëzojë të gjitha dokumentet relevante për rishikimet vjetore të sektorit shëndetësor siç kërkohet nga GAVI.

#### **17. Monitorimi dhe vlerësimi**

GAVI ka të drejtë të kryejë monitorim, evaluim, vlerësim të ndikimit, studime dhe kërkime të pavarura të Programit(Programeve) përkatës(e) me ose pa angazhimin e ndonjë pale të tretë. Qeveria do ta lehtësojë këtë proces (a) duke siguruar që GAVI dhe çdo përfaqësues apo agjent i autorizuar të kenë qasje në çdo kohë te personeli, dokumentet dhe objektet përkatëse; dhe (b) duke ofruar miratimet dhe ndihmën e nevojshme me logjistikën. Qeveria do të bashkëpunojë gjithashtu me GAVI-n për të ofruar informatat e kërkuara në mënyrë të arsyeshme nga GAVI për të kryer monitorim, evaluim, vlerësim të ndikimit, studime dhe kërkime në lidhje me Programet pasi Vendi nuk merr më mbështetje nga GAVI.

#### **18. Përdorimi i informatave nga GAVI**

Kur GAVI ka marrë ose krijuar informata në përputhje me këtë Marrëveshje, duke përfshirë pa kufizim informatat e marra ose krijuara në përputhje me paragrafët 6, 16 dhe/ose 17 të kësaj Shtojce 2, GAVI mund t'u zbulojë ose publikojë këto informata për palët e treta që mund të konsiderohen nga GAVI se kanë nevojë t'i dinë informatat e tilla, kur këto të fundit lidhen me performancën e një Programi dhe/ose, sipas mendimit të GAVI-t, me funksionimin herë pas here të objektivave të GAVI-t.

## 19. Menaxhimi dhe përdorimi i fondeve

Në lidhje me të gjitha fondet e ofruara nga GAVI, Qeveria do t'i përmbushë kërkesat e GAVI-t për përdorimin dhe menaxhimin e parave të gatshme, duke përfshirë sa vijon:

- (a) Qeveria do t'i përdorë paratë e gatshme vetëm për financimin e Aktiviteteve të Programit;
- (b) Qeveria do të sigurojë që fondet të menaxhohen me kujdes në përputhje me Politikën e TAP-it dhe kërkesat e Menaxhimit Financiar;
- (c) në rastin e parave të gatshme në vend të furnizimeve, fondet do të përdoren për blerjen e vaksinave në përputhje me mekanizmin e vetëprokurimit të përcaktuar në aplikimin e Vendit, i shqyrtuar dhe miratuar nga GAVI dhe i menaxhuar në përputhje me të gjitha udhëzimet, procedurat, standardet, kërkesat dhe rekomandimet e raportimit (nëse ka) për mekanizmat e vetëprokurimit dhe në përputhje me këtë Marrëveshje dhe Letrën(Letrat) përkatëse të Vendimit; dhe
- (d) Qeveria nuk do të përdorë asnjë para të gatshme të marrë nga GAVI për t'i përmbushur detyrimet e saj të bashkëfinancimit.

## 20. Keqpërdorimi i fondeve dhe furnizimeve

### 20.1. Keqpërdorimi i fondeve dhe furnizimeve

Në lidhje me të gjitha fondet dhe vaksinat dhe furnizimet e lidhura me to që i ofrohen Qeverisë në kuadër të Programit(Programeve), Qeveria do t'i përmbushë detyrimet dhe kërkesat për përdorimin e këtyre fondeve dhe furnizimeve, duke përfshirë sa vijon:

- (a) Qeveria do të përdorë fondet dhe vaksinat dhe furnizimet e lidhura me to të marra nga GAVI sipas një Programi për të vetmin qëllim të kryerjes së Aktiviteteve të Programit të këtij Programi specifik;
- (b) Qeveria do të sigurojë që të mos ketë keqpërdorim ose shpërdorim, ose aktivitete të korruptuara, të paligjshme ose mashtruese, që përfshijnë fondet dhe vaksinat dhe furnizimet e lidhura me to; dhe
- (c) Qeveria do të sigurojë që të gjitha shpenzimet në lidhje me përdorimin ose aplikimin e fondeve të evidentohen siç duhet me dokumentacion mbështetës, i cili është i mjaftueshëm për t'i mundësuar GAVI-t t'i verifikojë këto shpenzime.

Nëse Qeveria dështon ta respektojë ndonjëherë prej pikave të mësipërme, ngjarja e tillë do të konsiderohet "**Keqpërdorim**" (dhe shprehja "**Keqpërdorur**" do të interpretohet në përputhje me rrethanat).

### 20.1. GAVI përcakton Keqpërdorimin

GAVI do të ketë të drejtën në diskrecionin e tij absolut, por duke vepruar në mënyrë të arsyeshme për të përcaktuar nëse fondet e GAVI-t janë përdorur vetëm për të financuar Aktivitetet e Programit ose nëse ato janë Keqpërdorur (plotësisht ose pjesërisht).

## **20.2. Njoftim nga Qeveria**

Qeveria do të informojë menjëherë GAVI-n kur të vihet në dijeni për ndonjë keqpërdorim të mundshëm apo aktual në lidhje me ndonjë program.

## **21. Asetet e programit**

